



Republika e Kosovës
Republik of Kosova
Republika Kosovo



Komuna e Vitisë
Municipality of Vitina
Opstina Vitina

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, neni 5, pika d, neni 35, pika 1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 dhe të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.08/14, të datës 25.02.2014, për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorëve dhe të zëvendësrektorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S P U B L I K

(Rishpallje)

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në institucionet edukativo-arsimore

- Drejtor shkolle në SHF "Nazmi Pajaziti" në Radivojcë
- Drejtor shkolle në SHF "Ndre Mjeda" në Kabash

Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët që konkurrojnë në këtë konkurs:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor (së paku kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) nga profilet e pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe normativit mbi punësimin e kuadrit mësimor dhe rregullat tjetër ligjore;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit dhe ata që janë në procedurë të licencimit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim;
- Të kenë më së paku 3 vjet përvojë pune në arsim ose në institucione të arsimit.

Kandidatët duhet të posedojnë-dorëzojnë këto dokumente:

- Çertifikatën e lindjes;
- Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës;
- Dëshminë për përvojën e punës;
- Portofolin profesional (shih shtojcën G);
- Letër referencë nga një institucion publik – kredibil (Ministria për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, DKA-ja, Këshilli Drejtues i Shkollës, punëdhënësi paraprak, institucionet e arsimit të lartë). Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuuese për punën dhe angazhimet paraprake;
- Planin zhvillimor të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues për të cilin ka konkurruar (së paku 10 faqe tekst, me hapësirë 1.5, fonti i shkronjave me 12, arial), sipas udhëzimit të MASHT-it;
- Çertifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion shëndetësor publik, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- Dëshminë se nuk është nën hetime;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovës si dhe nëpër kolegje private brenda Republikës së Kosovës, e që konkurrojnë për këtë pozitë, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr.8/2010 të datës 22.06.2010, në të kundërtën, komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk i kanë plotësuar kushtet e konkursit.

Kandidatët e interesuar aplikacionet i marrin dhe i dorëzojnë në Drejtorin Komunal për Arsim në Viti. Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Viti, më 11.05.2018

Drejtoria për Arsim